



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 128, datë 27.04.2021

MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKUROREN ANITA JELLA, KANDIDATE PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DURRËS

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159, pika 1 dhe 2 germa "a", 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 52, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në pikën 5, të nenit 9, të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit të prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe në germën "ç", pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar si dhe pasi u njoh me Relacionin "Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokuroren Anita Jella, candidate për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Durrës", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:


1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokuroren Anita Jella, candidate për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatës prokurore Anita Jella të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
3. Të njoftohet për këtë vendim znj. Anita Jella.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**




**ANËTAR
BUJAR SHESHI**



**ANËTAR
NURIHAN SEITI**



**ANËTAR
SANDËR BECI**



**ANËTAR
VATË STAKA**




**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**



**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**



**ANËTAR
MOISI DUDA**

